

Vendim nr. 76 datë 11.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: JULIAN CACA, përfaqësuar nga avokate Brikena Kasmi, me prokurë.

SHOQATA RINORE SPORTIVE STUDENTI SH.P.K., përfaqësuar nga avokate Brikena Kasmi, me prokurë.

OBJEKTI: Anulimi ose konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit, datë 25.05.2023 të Këshillit Drejtues të Federatës Shqiptare Taekwondo World për pezullimin për 2 vjet të zotit Julian Caca si trajner, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Anulimi ose konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit, datë 25.05.2023 të Këshillit Drejtues të Federatës Shqiptare Taekwondo World, për kalimin me status provizor në asamblenë e radhës të Shoqatës Rinore Sportive Studenti, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dëmshpërblimi për shkak të: (i) fitimit të munguar; (ii) shkakimit të dëmit moral; (iii) konkurrencës së pandershme; dhe (iv) diskriminimit.

Pezullimi i ekzekutimit në mënyrë të menjëhershme të vendimit, datë 25.05.2023 të Këshillit Drejtues të Federatës Shqiptare

Taekwondo World, për shkak se zbatimi i normës konkrete mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pezullimi i ekzekutimit të procesit të rinovimit të licencimit/anëtarësimit vjetor për vitin 2024 që po kryhet nga Federata Shqiptare Taekwondo World sipas e-mail-it të datës 08.01.2024, për shkak se zbatimi i procesit ndikon drejtpërdrejt në të drejtat kushtetuese të palës ankimuese, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 35, 41, 42, 131, 134 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 79/2017 “Për sportin”; Rregullorja e Brendshme dhe Kodi i Etikës i Federatës Shqiptare Taekwondo World; Rregullorja e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar në datën 28.05.2022; Kodi i Procedurës Administrative; nenet 419 e vijues, 608 e vijues, 640 e vijues, 638 e vijues të Kodit Civil (*KC*), të ndryshuar; ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e konsumatorit”; ligji 48/2014; ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*);

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorën e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Julian Caca është një nga anëtarët themelues të Shoqatës së Arteve Marciale “Tae Kicks”, e cila është regjistruar si organizatë jofitimprurëse me vendimin nr. 5023, datë 03.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. 5023/1, datë 09.11.2021 të kësaj gjykate, kjo organizatë ka vendosur ndryshimin e emrit në Shoqata Rinore Sportive Studenti (*kërkuesja tjetër*). Në datën 22.11.2021 Shoqata Rinore Sportive Studenti dhe Klubi Shumësportësh Studenti kanë lidhur një kontratë bashkëpunimi, ku kërkuesi Julian Caca është punësuar si trajner në këtë klub.

2. Federata Shqiptare Taekwondo World (*FSHTW*) është person juridik në formën e shoqatës, e regjistruar me vendimin nr. 2990, datë 26.01.2011 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas nenit 1 të statutit të saj, kjo federatë përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave sportive, klubeve sportive dhe shoqërive sportive të sportit të Taekwondo World në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa sipas nenit 6, pezullimi ose përjashtimi i anëtarit të federatës bëhet me vendim të arsyetuar të Asamblesë së Përgjithshme. Nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur kërkesës, Shoqata Rinore Sportive Studenti ka rezultuar anëtare e FSHTW-së.

3. Me vendimin e datës 25.05.2023, Këshilli Drejtues i FSHTW-së, bazuar në kërkesën e Komisionit Disiplinor të kësaj federate sportive, ka vendosur pezullimin për 2 vjet të kërkuesit Julian Caca si trajner me motivacionin “*Sjellje joetike kundrejt gjyqtarëve në aktivitete zyrtare, prishje të imazhit të sportit të Taekwondo*”, si dhe kalimin me status provizor në asamblenë e radhës të Shoqatës Rinore Sportive Studenti (*për përfaqësim në aktivitete zyrtare me simbole që i takojnë Klubit Studenti dhe regjistrim në aktivitete ndërkombëtare si Klub Studenti*).

4. Në datën 27.10.2023 kërkuesit kanë paraqitur një kërkesëpadi në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) me objekt anulimin ose konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të Këshillit Drejtues të FSHTW-së të datës 25.05.2023 dhe dëmshpërblim për shkak të fitimit të munguar, dëmit moral, konkurrencës së pandershme dhe diskriminimit.

5. Në datën 19.01.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, me aktet e kërkuara është regjistruar në datën 20.02.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:
- 6.1. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi referuar dispozitave ligjore KAS-i është një gjykatë e posaçme dhe kërkuesit nuk mund t'u drejtohen gjykatave të zakonshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Mosfunksionimi i KAS-it, si gjykatë e posaçme, e bën efektivisht të pamundur të drejtën e kërkuesve për t'u ankuar ndaj një vendimi të dhënë që kufizon të drejtat e tyre. Për këtë shkak, kërkuesit Julian Caca i është cenuar edhe *e drejta e ushtrimit të profesionit*.
- 6.2. *E drejta e aksesit*, pasi FSHTW-ja nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet për rishikimin e vendimit dhe nuk u ka kthyer përgjigje disa komunikimeve të kërkuesve për t'u informuar për shkaqet ose provat mbi bazën e të cilave është nisur një procedim disiplinor, ose është pezulluar licenca. Ata nuk janë ftuar asnjëherë në bisedime në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Megjithëse kërkuesit i janë drejtuar disa herë FSHTW-së për t'u njohur me shkaqet e procedimit disiplinor, procedurën e ndjekur, provat për shkeljen e pretenduar etj., ata nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *e drejta për t'u dëgjuar*. Po kështu, si pasojë e mosnjohimit të pezullimit, kërkuesve u është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike*.
- 6.3. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi në vendimin e kundërshtuar nuk janë arsyetuar shkaqet dhe rrethanat që rrjedhin nga veprime ose mosveprime të mundshme të kërkuesve që kanë sjellë shkaqe disiplinore. Ndonëse masat disiplinore janë të parashikuara në ligj, në rastin konkret është e paqartë se si duhet të kuptohet shkelja e kërkuesve, për rrjedhojë kjo masë është e pavlefshme.
- 6.4. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, si një e drejtë e çdo shtetasi për t'u marrë me sport për shkak se kërkuesi Julian Caca nuk ishte bërë pjesë e procesit disiplinor dhe nuk ishte njohur me shkaqet e tij.

- 6.5. *Liria e organizimit*, e garantuar nga neni 46 i Kushtetutës, pasi anëtarësia në FSHTW përkon edhe me të drejtën e kërkuesve për të shprehur lirisht të drejtën e tyre në procesin e votimit të organeve drejtuese. FSHTW-ja nuk ka respektuar ligjin në drejtim të mungesës së njoftimit të ankesës, procedurës së ankimit, afateve etj.
- 6.6. *Liria e veprimtarisë ekonomike*, e garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi procesi disiplinor nuk ka qenë i mbështetur në ligj dhe në prova. Trajneri dhe anëtari i FSHTW-së lidhin një kontratë pune ndërmjet tyre në zbatim të legjisllacionit shqiptar që rregullon marrëdhëniet e punës. Licenca e trajnerit është një dokument zyrtar e cila kryhet në dy muajt e parë të vitit kalendarik dhe FSHTW-ja është i vetmi institucion që ka të drejtë të japë licencën e ushtrimit të profesionit të trajnerit etj. Gjithashtu, është cenuar edhe *parimi i proporcionalitetit*, i garantuar në nenin 17 të Kushtetutës, pasi për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit dhe mosnjohjes së kërkuesve me dokumentet dhe shkaqet ligjore për kufizimin e të drejtave të tyre kushtetuese, nuk mund të vlerësohet përshtatshmëria, domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i masës.
- 6.7. *Parimi i lojës së ndershme dhe korrekte*, i udhëhequr nga idealet olimpike dhe parimet e etikës sportive për shkak të presioneve të vazhdueshme që kërkuesit kanë pasur nga FSHTW-ja.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

7. Kolegji vëren se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Në kushtet kur objekt i ankimit kushtetues individual është anulimi ose konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimeve të këshillit drejtues të FSHTW-së, Kolegji vlerëson se fillimisht duhet të analizohet juridiksioni i Gjykatës për këto lloj vendimesh.

9. Referuar nenit 23 të ligjit nr. 79, datë 27.04.2017 “Për sportin”, të ndryshuar (*ligji nr. 79/2017*), federatat sportive krijojnë organet e gjyimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara

në statutin e tyre, të cilat shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së federatave përkatëse. Po sipas këtij neni, vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të federatave mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv brenda 15 ditëve kalendarike nga shpallja e tyre. Ndërsa sipas nenit 24 të këtij ligji, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjal, i cili vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin. Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet në Asamblenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Rregullorja e KAS-it, nga ana tjetër, parashikon se vendimet e KAS-it mund të ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit, në Lozanë të Zvicrës, brenda 90 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar me shkrim. Ankimi i vendimit të KAS-it në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të tij (*neni 29*).

10. Ndërkohë, ligji nr. 79/2017 përcakton se “Federata sportive” është person juridik në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar (*neni 3, pika 6*), ndërsa ajo ka si detyrë, ndër të tjera, të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë aktivitetet sportive zyrtare në nivel kombëtar, në bazë të rregulloreve të miratuara, të marrë masa për parandalimin dhe të luftojë dhunën, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën, të licencojë trajner për sportin përkatës, të japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive sportive për anëtarët e saj, ndërkohë që asnjë person juridik, privat ose publik nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj (*neni 18*). Po kështu, ky ligj përcakton se Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është organizatë e pavarur jofitimprurëse (*neni 3, pika 11*), ndërsa në të aderojnë federatat shqiptare, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë dhe fizikë, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij komiteti (*neni 14, pika 6*). Gjithashtu, ky ligj përcakton edhe se Gjykata e Arbitrazhit të Sportit në Lozanë të Zvicrës është një organ ndërkombëtar gjyqësor, i krijuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me sportin përmes arbitrazhit (*neni 3, pika 7*).

11. Referuar objektit dhe përmbajtjes së kërkesës në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesit kanë ngritur disa kërkime përpara Gjykatës, duke kundërshtuar vendimet e Këshillit Drejtues të FSHTW-së, të cilat janë marrë në zbatim të ligjit nr. 79/2017 dhe statutit të saj. Ata kanë pretenduar

se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, e drejta e aksesit, e drejta për t'u dëgjuar, parimi i sigurisë juridike, standardi i arsytimit të vendimit, parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, e drejta e ushtrimit të profesionit, liria e organizimit dhe ajo e veprimtarisë ekonomike, si dhe parimi i lojës së ndershme dhe korrekte. Kërkuesit kanë kërkuar edhe marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të vendimit të këshillit drejtues të FSHTW-së dhe pezullimin e ekzekutimit të procesit të rinovimit të licencimit dhe anëtarësimit vjetor për vitin 2024 dhe shpërblimin e dëmit.

12. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se vendimet objekt kundërshtimi nuk konsiderohen akte të pushtetit publik dhe nuk janë nxjerrë nga organe që i përkasin pushtetit publik, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Ligjvënësi ka parashikuar se mosmarrëveshjet në fushën e sportit zgjidhen nga organet e drejtësisë sportive, të cilat ngrihen dhe funksionojnë pranë organizatave sportive vullnetare (jofitimprurëse) vendase, ndërsa vendimet e organit më të lartë vendas (Këshillit të Arbitrazhit Sportiv) mund të ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit, në Lozanë të Zvicrës, që është një organ ndërkombëtar gjyqësor i krijuar pikërisht për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me sportin përmes arbitrazhit. Në këtë kuptim, vendimet objekt kundërshtimi të Këshillit Drejtues të FSHTW-së nuk janë akte të pushtetit publik, por të një personi juridik privat.

13. Rrjedhimisht, kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Në këto kushte, Kolegji çmon se bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577/2000, edhe kërkimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Këshillit Drejtues të FSHTW-së dhe të procesit të rinovimit të licencimit/anëtarësimit vjetor për vitin 2024 që po kryhet nga ajo federatë nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.